

VENDIM
Nr. 507, datë 24.6.2020

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA DEPARTAMENTI I
ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK TEK
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, TË GODINËS SË ISH-MINISTRISË SË
INTEGRIMIT EVROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, të godinës së ish-Ministrisë së Integrimit Evropian, sipas planimetrisë që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i kalon në përgjegjësi administrimi oborri, kati përdhes, kati i parë e i dytë i godinës.

3. Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e godinës së përcaktuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Vendimi nr. 704, datë 1.12.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga ish-Ministria e Integrimit Evropian te Departamenti i Administratës Publike dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të godinës së ish-Ministrisë së Integrimit Evropian”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Departamenti i Administratës Publike, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



